



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Drejtoria Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve
Sektori i Transparencës dhe Komunikimit

Lënda: *Minutat e takimit nga diskutimi i publikut për projektvendimin*

“Për procedurat dhe kërkesat e hollësishme për lidhjen e marrëveshjes vullnetare ndërmjet organizatave dhe grupeve, që përfaqësojnë interesa të caktuar, grupeve të operatorëve ose operatorëve individualë me autoritetet përkatëse, që të realizojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përbërës mjedisor”.

Ditën e mërkurë datë 08.04.2015, në ambjentet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për projektvendimin “Për procedurat dhe kërkesat e hollësishme për lidhjen e marrëveshjes vullnetare ndërmjet organizatave dhe grupeve, që përfaqësojnë interesa të caktuar, grupeve të operatorëve ose operatorëve individualë me autoritetet përkatëse, që të realizojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përbërës mjedisor”.

Në këtë takim merrnin pjesë këta përfaqësues të Shoqërisë Civile:

Znj. Ana Taga, nga Federata e Gjuetarëve Shqipëtar;
Znj. Dorina Papa, Universiteti Polis
Znj. Marçela Mele, Universiteti Polis
Z. Klodian Aliu, Delegacioni European

Nga Ministria e Mjedisit morën pjesë këta përfaqësues:

Znj. Ornela Shoshi, Përgjegjëse në Drejtorinë e Mjedisit;
Znj. Madalena Koja, Përgjegjëse Drejtoria Juridike e Komunikimit dhe Prokurimeve;
Znj. Ilda Shahu, specialiste Drejtoria e Mjedisit;
Znj. Borana Andoni, specialiste Drejtoria e Mjedisit
Znj. Edlira Dersha, specialiste, Sektori i Transparencës dhe Komunikimit;
Znj. Florinda Avdullaj, specialiste Drejtoria Juridike e Komunikimit dhe Prokurimeve;
Znj. Sabina Cenameri, specialiste e Sektorit të Programimit dhe Koordinimit Ndërinstitucional;

Dëgjesa u hap nga znj. Ornela Shoshi, e cila ju shpjegoi të pranishmë rëndësinë e kësaj dëgjese për të ndihmuar procesin e hartimit të akteve nënligjore .

Më pas prezantimin për këtë draft Vendim të Këshillit të Ministrave e bëri znj. Ilda Shahu, e cila solli para të pranishmëve qëllimin se këtij projektakti është përcaktimi i një procedure për realizimin e një niveli mbrojtjeje më të lartë sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përbërës mjedisor, gjithashtu ky akt është hartuar në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji i Mjedisit.

Në këtë prezantim u bënë të njohura nga znj. Shahu, se organizatat dhe grupet, që përfaqësojnë interesa të caktuara ose grupe operatorësh ose operatorë individualë mund të ishin palët që mund të kërkonin nënshkrimin e një marrëveshje vullnetare me Ministrinë e Mjedisit.

Gjithashtu u sqarua se cila ishin procedurat që duhet të ndiqeshin për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dokumentacioni që duhej plotësuar nga palët e interesuara.

Z. Klodian Aliu pyeti nëse mund të realizoheshin inisiativa dhe pa pasur marrëveshje.

Znj. Shoshi theksoi se kjo marrëveshje do të shërbente dhe si një lloj publiciteti për kompaninë, që nëpërmjet përdorimit të teknologjive që përdor sjellë përmirësim të mjedisit.

Takimi u mbyll duke i ftuar të pranishmit nga shoqëria civile se nëse do kishin komente t'i nisnin ato elektronisht në adresën zyrtare të Ministrisë së Mjedisit info@moe.gov.al .